



## BASHKIA MIRDITË

### 1. TAKSAT VENDORE

#### 1.1. TAKSA VENDORE MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË BIZNESIT TË VOGËL

Çdo person fizik apo juridik, i cili kryen një veprimtari ekonomike (biznes) me anën e të cilit realizohet qarkullim vjetor më i vogël ose i barabartë me 8 milion lekë i detyrohet pagesës së detyrimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit për biznesin e vogël.

**Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me qarkullim vjetor nga 5 - 8 milionë lekë.**

- **Shkalla tatimore e aplikueshme 5%.**

**Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me qarkullim vjetor 0 - 5 mln**

- **Shkalla tatimore e aplikueshme 0.**

*Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve Lezhë, llogarit, njofton dhe ndjek arkëtimin e detyrimit të Biznesit të Vogël për llogari të Administratës Vendore të bashkisë Mirditë.*

### 2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

#### 2.1 TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME "NDËRTESE"

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa Brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.

##### ○ **LLOGARITJA E SHUMËS SË TAKSËS SË NDËRTESES/ NJËSISË PRONËSORE**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues.

Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me

një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) **0,05%** - për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) **0,2%** - për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) **30%** - e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për vitin 2020 çmimi vlerësues i ndërtesave për efekt të vlerësimit tatimor është si më poshtë:

o **NDERTESA BANIMI**

Nr.	Emertimi	Çmimi mesatar referues sipas VKM	Propozojmë -30% të shkallës taksës	Lekë/m2/sipërfaqe
1.	Njësia Administrative Rrëshen	42 000	Pa ndryshuar	21 lek/m2

2.	Njësia Administrative Rubik	29 500	Pa ndryshuar	14.75lek/m2
3.	Njësia Administrative Fan	42 000	29 400	14.7 lek/m2
4.	Njësia Administrative Orosh	42 000	29 400	14.7 lek/m2
5.	Njësia Administrative Kaçinar	42 000	29 400	14.7 lek/m2
6.	Njësia Administrative Kthellë	42 000	29 400	14.7 lek/m2
7	Njësia Administrative Selitë	42 000	29 400	14.7 lek/m2

Për të gjitha ndërtesat e kategorive dhe nenkategorive të tjera të jete sipas VKM nr. 168 datë 27.3.2019 aneksi nr 2.

o **ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM**

- a) **Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë**

kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 1.5 = 63,000 * 0.2\% = 126 \text{ lek/m}^2$*

*Rubiku  $29,500 * 1.5 = 44,250 * 0.2\% = 88,5 \text{ lek/m}^2$*

- b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është **70%** (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 70\% = 29,400 * 0.2\% = 58.8$*

*Rubiku  $29,500 * 70\% = 20,650 * 0.2\% = 41.4 \text{ lek/m}^2$*

- c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është **30%** (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 30\% = 12,600 * 0.2\% = 25.2 \text{ lek/m}^2$*

*Rubiku  $29,500 * 30\% = 8,850 * 0.2\% = 17,7 \text{ lek/m}^2$*

- d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është **50%** (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 50\% = 21,000 * 0.2\% = 42 \text{ lek/m}^2$*

Rubiku

$$29,500 * 50\% = 14,750 * 0.2\% = 29,5 \text{lek/m}^2$$

- e) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është **30%** (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 30\% = 12,600 * 0.2\% = 25.2 \text{lek/m}^2$*

Rubiku

$$29,500 * 30\% = 8,850 * 0.2\% = 17.7/m^2$$

- f) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është **70%** (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

*Konkretisht: Rresheni dhe njesite e tjera;  $42,000 * 70\% = 29,400 * 0.2\% = 58.8 \text{lek/m}^2$*

Rubiku

$$29,500 * 70\% = 20,650 * 0.2\% = 41,3 \text{lek/m}^2$$

o **PERJASHTOHEN NGA TAKSAT MBI NDERTESAT (SIPAS VKM.NR.132):**

- + Pronat e shtetit dhe te njesive te veteqeverisjes vendore qe perdoren per qellime jofitimprurese
- + Pasurite ne pronesi te shtetit, te kaluara me VKM nen adminstrimin e shoqerive publike shteterore
- + Ndertesat e banimit qe shfrytezohen nga qiramarresi me qira te paliberalizuara.
- + Banesat sociale ne pronesi te bashkive
- + Pasurite e palujtshme, prone e subjekteve juridike ose fizike qe ne baze te marreveshjeve me bashkite perdoren per banesa sociale.
- + Ndertesat qe perdoren nga komunitete fetare ,ne funksion te veprimtarise se tyre
- + Strukturat akomoduese “Hotel/resort me kater yje, status sociale sipas percaktimit ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbajtes te nje marke tregtare te rgjistruardhe njohur nderkombetarisht”brand name”
- + Ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe perfitojne pension pleqerie/pension social ose pension social, kur familjet e tyre perbehen vetem nga pensionite,ose dhe me persona ne ngarkim te tyre, qe jane te paafte për punë.
- + Ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike.
- + Ndertesat kulturore, nen mbrojtje te perkoheshme ose te perhereshme, per kohen ne te cilen deklarohet mbrojtja sipas legjislacionit ne fuqi per monumentet e kultures dhe/ose te trashegimise kulturore,të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

## **2.2.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE**

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda vitit fiskal.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi/përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësive, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetedeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore pranë bashkisë ku ndodhet toka (ndryshuar me ligjin 142/2015 datë 17.12.2015).

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

○ <b>KATEGORITË E TOKËS BUJQËSORE</b>	<b>LEKË /HA / VIT</b>	
	<b>Sipas ligjit</b>	<b>Bëhet(-30%)</b>
Klasa I	1 400	980
Klasa II	1 200	840
Klasa III	1 100	770
Klasa IV	1 000	700
Klasa V	900	630
Klasa VI	800	560
<b>Klasa VII</b>	<b>700</b>	<b>490</b>

Për taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, jepet lehtësim ose përjashtim i përkohshëm. Kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar, deri në vlerën **75 %** (shtatëshjetë e pesë) përqind.

○ **Përijashtohen nga taksa bujqësore:**

✚ Sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **5 (pesë)** vitet e para.

✚ Toka bujqësore e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore në masën **75 % (shtatëdhjetë e pesë)** përqind e vlerës së taksës për sipërfaqen e dëmtuar.

### **2.3 TAKSA MBI TRUALLIN**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m<sup>2</sup> (metër katror), në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësive përdoruesi i truallit bën një vetedeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli, (ndryshuar me ligjin 142/2015 datë 17.12.2015).

Niveli i taksës caktohet në lekë për m<sup>2</sup> (metër katror). Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1, të këtij ligji.

Sipas kategorizimeve të bashkive, të bëra me ligj, taksa mbi truallin është në masën:

	Përshkrimi	Sipas ligjit	Propozohet
1	Për qëllime banimi nga individët	<b>0.14 lek/m<sup>2</sup>/vit</b>	<b>0.12 lekë/m<sup>2</sup>/vit</b>
2	Për qëllime biznesi,	<b>12 lekë/m<sup>2</sup>/vit</b>	<b>12 lekë/m<sup>2</sup>/vit</b>

### 3.. TAKSA VENDORE MBI VEPRIMTARINË E SHËRBIMIT HOTELIER

- a. Për qëllim të këtij ligji, me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, bujtinë, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- b. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- c. Niveli tregues i taksës është sipas aneksit 8 të ligjit për taksat dhe tarifat vendore.
- d. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. (Ndryshuar me ligjin 142/2015 datë 17.12.2015).
- e. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- f. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës **5 (pesë) të muajit** pasardhës.
- g. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo në juridikson te se ciles ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës **5 (pesë) të muajit** pasardhës.

KATEGORITË	Lekë për natë fjetje sipas ligjit	Propozohet - 30%
Hotel 4, 5 yje	175	122.5
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.	70	49

Pagesa kryhet brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

### 4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

- Niveli i takses se ndikimit ne infrastrukture percaktohet sipas Ligjit nr. 9632 dt.30/10/2006, "Per Sistemin e Taksave Vendore" (te ndryshuar).
- Baza e takses eshte vlera ne leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet.
- Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat perkatese percaktohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per dhenien e lejes se ndertimit.

Niveli i takses eshte si vijon:

**a. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi nga shoqëritë e ndërtimit**, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa ndikimit në infrastrukture është në masën 3-4% (kater) përqind të cmimit të shitjes për m<sup>2</sup>. Cmimi i shitjes për m<sup>2</sup> (meter katror) bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.

**b. Në rastin e ndërtimeve për qëllime shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit**, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa ndikimit në infrastrukture është në masën 5 % (pese) përqind të cmimit të shitjes për m<sup>2</sup> katror. Cmimi i shitjes për meter katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.

**c. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2**, niveli i takses shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për bashkinë Mirditë është deri në **3%** (tre) përqind e saj, dhe konkretisht:

- Ndërtime me funksion prodhim, përpunim dhe ruajtje produktesh bujqësore dhe blegtorale, (stalla, komplekse, depo etj. të ngjashme) **1%** (një) përqind e vlerës së investimit.
- Ndërtime me funksione për industrinë prodhuese dhe përpunuese etj. të ngjashme **3%** (tre) përqind e vlerës së investimit.
- Objekte me përdorim në sektorin e turizmit **1%** (një) përqind.

**c. Per projektet e infrastruktures, per ndertimin e rrugeve kombetare, te porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndertimit te infrastruktures ne energji, perfshire makinerite dhe pajisjet per keto projekte**, taksa e ndikimit në infrastrukture e ndërtimeve të reja është **0.1%** (zero pik një) përqind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastruktures së demtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

**d. Per ndertesat te cilat jane ne proces legalizimi**, taksa e ndikimit në infrastrukture e ndërtimeve të reja është **0.5%** (zero pik pesë) përqind e vlerës së investimit.

Detyrimi për pagesën e takses i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast mbledhet nga organi që leshon lejen e ndërtimit dhe arketohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikohet në infrastrukturen e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe ndikimit të investimit në infrastrukturen e secilës bashki".

e. Per punime qe kryhen ne zbatim te vendimit Nr. 408, datë 13.5.2015 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, neni 6, Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, tarifa e pajisjes me Autorizimin përkates është. ..**2 000 - 5 000 lekë.**

f. Per punime qe kryhen ne zbatim te vendimit Nr. 408, datë 13.5.2015 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, Neni 7, Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh, tarifa e aplikimit është..... **5 000 - 10 000 lekë.**

- **Perjashtohen nga pagesa e kesaj takse;** investimet e kryera per ndertimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pese yje, status special" sipas percaktimit ne legjislacionin fushes se turizmit dhe qe jane mbajtes te një marke tregtare te regjistruar dhe te niohur nderkombetarisht brand name" (ndryshuar me ligjin 142/2015).
- Perjashtohen nga pagesa e kesaj takse edhe investimet e subjekteve, te cilat zhvillojne veprimtari pritëse të certefikuar si “agroturizem”, sipas legjislacionit ne fuqi ne fushen e turizmit.

#### **Menyra e pageses:**

- Taksa paguhet brenda **5** (pese) diteve nga data e marrjes se vendimit per miratimin lejes per punime dhe leshimit te autorizimit te pageses nga Drejtoria e Pergjithshme Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit. Ne rast se kerkuesi nuk kryen pagesen brenda **5** (pese) diteve pune nga njoftimi per detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atehere per cdo vonese i llogaritet kamate **0.2%** (zero pik dy) perqind ne dite e shumes qe duhet te paguaje, deri ne **30** (tridhete) dite pune. Nese ne perfundim te ketij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kryetari i bashkise vendos masa te tjera te pershtatshme deri revokimin e vete lejes se miratuar.
- Per kategorite ku niveli i takses aplikohet mbi vleren e investimit, ne perfundim te punimeve te kryera sipas lejes se miratuar, behet kontrolli i pagesave me situacionin perfundimtar te objektit te ndertuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe nese ka diferenca mes vleres se investimit sipas situacionit perfundimtar dhe preventivit njoftohet subjekti per vleren e diferences qe eshte i detyruar te shlyeje. Mosshlyerja e ketij detyrimi perben shkak per pezullimin e procedurave te pajisjes me leje perdorimi te subjektit.

*Struktura e ngarkuar per perlllogaritjen dhe leshimin e autorizimit per pagesen e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja eshte drejtoria e planifikimit. zhvillimit te territorit dhe strehimit, prane bashkise Mirdite. Me arketimin e takses se ndikimit ne infrastrukture i jepet subjektit leja per fillimin e punimeve*

#### **5. TAKSA E TABELËS**

Mbështetur në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, dhe ligjin 142/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632 dt 30.10.2006, ligji 106/2017 datë 30.11.2017 aneksi 7.

Taksa e tabelës aplikohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.



Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe profesioneve të lira.

**Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme:**

<b>Nr.</b>	<b>Llojet e tabelave</b>	<b>Nj/matëse lekë m<sup>2</sup>/vit</b>	<b>Bashkia Mirditë</b>
<b>1</b>	<b>Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)</b>		
<b>a</b>	<b>deri në 2 m<sup>2</sup></b>	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	0
<b>b</b>	<b>Mbi 2 m<sup>2</sup> deri në 10 m<sup>2</sup></b>		
	-e thjeshtë (pa ndricim)	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	7 000
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	11 500
	-elektronike	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	15 000
	<b>Mbi 10 m<sup>2</sup> deri në 20 m<sup>2</sup></b>		
	-e thjeshtë (pa ndricim)	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	5 950
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	9 775
	-elektronike	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	12 750
<b>c</b>	<b>Mbi 20m<sup>2</sup> deri në 40 m<sup>2</sup></b>		
	-e thjeshtë(pa ndricim)	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	3 850
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	6 325
	-elektronike	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	8 250
<b>d</b>	<b>Mbi 40m<sup>2</sup></b>		
	-e thjeshtë (pa ndricim)	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	2 800
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	4 600
	-elektronike	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	6 000
<b>2</b>	<b>Tabele për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.</b>		
	tabele identifikuese	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	120
<b>3</b>	<b>Tabele për qëllime reklamimi e levizshme e palevizshmederi në tavanin</b>		

	<b>maksimal 35 m<sup>2</sup></b>		
	e thjeshtë	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	13 500
	elektronike	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	27 000
<b>4</b>	<b>Tabele në funksion të ekspozimeve të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.</b>		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë / m <sup>2</sup> / vit	1 000

#### ❖ NË KATEGORINË I.

**Tabelë për qëllime identifikimi** është tabela brenda ose jashtë territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi me pamje ballore dhe që nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe /ose lloji i aktivitetit të kompanisë ose jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim. Taksa e tabelës paguhet për cdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB-së.

#### ➤ NË KATEGORINË II:

Në këtë kategori përfshihen:

**Në kategorinë e tabelës për qëllime reklamimi** (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjitha tabelat e vendosura në pamje joballore, të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone, të vendosura në pjesë të rrugës, shtylla etj. që kanë përmbajtje reklamimi për vete ose të tretë dhe konkretisht:

- Të gjitha reklamimet statike, ndriçuese ose jo ndriçuese, faqet murale, faqe adezive reklamuese dhe autolëvizëse dhe të gjitha reklamimet e lëvizshme me fletë, pamje dy ose tre vizionëshe, elektromekanike me ose pa ndriçim.
- Tabelat elektronike (të lëvizshme dhe të palëvizshme) për qëllime reklamimi, do të kuptojmë reklamimet dixhitale, lineare me të gjithë elementët gjysëm - përçues etj.

#### ❖ NË KATEGORINË III:

Vendosje tabele në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjitha ato tabela në funksion të panairëve të ndryshme etj. që kanë si qëllim reklamimi për vete ose për të tretët.

- Baza e taksueshme është sipërfaqja në m<sup>2</sup>.
- Drejtoria e Urbanistikës, pasi shqyrton kërkesën e subjektit, jep lejen për vendosjen e reklamës.
- Në lejen e lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës, përveç të tjerave, detyrimisht përcaktohen vendi i vendosjes, lloji i reklamës, sipërfaqja. etj.

- Një kopje e lejes se lëshuar i përcillet Drejtorisë se Taksave.
- Drejtoria e Taksave llogarit e arkëton taksën e reklamës për vitin kalendarik nga data e vendosjes se saj, sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Urbanistika.

## **6.TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve ligjore.

### **6.1 TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

- a. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- b. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr. 3 të ligjit 9632 datë 30.10.2006, “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndyshuar.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.

Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

- Baza e taksës së kalimit të pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes se tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është **2 % (dy) përqind.**

Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

#### **Aneksi 3.**

<b>Kategoritë e ndërtesave</b>	<b>Vlera e taksës në lek/m<sup>2</sup></b>
Ndërtesa banimi	100
Ndërtesa të tjera tregti e shërbime	300
Ndërtesa të tjera	200

Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë se Paluajtshme nuk bëjnë çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vertetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vertetimin e bashkisë apo i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit (ndryshuar me ligjin 10146 date 28.9.2009).

*Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen e kësaj takse është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mirditë, në cilësinë e agentit tatimor, i cili përfiton 3 % (tre) përqind të*

shumës së arkëtuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim - Taksave Vendore pranë bashkisë Mirditë, si strukturë e ngarkuar për arkëtimin e kësaj takse.

## 6.2 TAKSA VJETORE PËR QARKULLIMIN E MJETEVE TË PËRDORURA

Përshkrimi	Niveli i taksës
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	25 %

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbliidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është Drejtoria Rrugore e Transportit. Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë bën rakordimet me DSHTR-në dhe planifikimin e të ardhurave për këtë taksë.

## 6.3. RENTA MINERARE

Përshkrimi	Niveli i taksës
Renta minerare	5 %

Sipas ligjit pagesa e rentës bëhet brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** të muajit pasardhës kur janë realizuar, dhe Drejtorite e Doganave ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e shitjes së produktit mineral jashte vendit.

Në rastin e shitjes së produktit mineral brenda vendit Degët Rajonale të Tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente dhe pagesa e rentës bëhet brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** të muajit pasardhës kur janë realizuar shitjet. Drejtoria e Tatim-Taksave pranë bashkisë bën rakordimet me Drejtorite përkatese.

## 6.4. TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Përshkrimi	Niveli i taksës
Të ardhurat nga tatimi të ardhurat personale	2 %

Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

## TË TJERA

## 7. TË ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga shërbimet përfaqësojnë ato burime që pushteti lokal i siguron kundrejt shërbimeve që u ofron shtetasve, shërbime si të karakterit administrativ dhe ekonomik.

### **Klasifikimi i tyre është:**

- shërbimet publike që ato ofrojnë (duke shtuar shërbimet që bashkitë do të ofrojnë në kuadër të funksioneve të reja të transferuara);
- të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;
- dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe lëshimit të dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;
- çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj (duke i lënë hapësirë bashkive të ndryshme që në varësi të situatave të ndryshme ekonomike dhe shërbimeve të ndryshme që ofrojnë të vendosin tarifa të reja të përkohshme).
- Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.

### **Në këtë grup përfshihen:**

- të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë;
  - të ardhurat nga partneritetet privato-publike;
  - bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.
- ✚ Në mbështetje të ligjit 68/2017 “Për vetëqeverisjen vendore” bashkia ka autoritet të plotë për përcaktimin e sistemit dhe nivelit të tarifave për shërbimet të cilat u përkasin funksioneve ekskluzive të tij.
- ✚ Njesite e qeverisjes vendore mund të aplikojnë tarifa për të gjitha shërbimet që rrjedhin nga ushtrimi i funksioneve të veta si mbledhja e mbeturinave, ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve, dekori, funeralet, mirëmbajtja e rrugëve rurale, shërbimi i zjarfikëseve, shërbimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave etj.
- ✚ Në sistemin e tarifave duhet të mbahet parasysh një lidhje sa më e fortë midis tarifës së aplikuar dhe asaj të vjelur si dhe qëllimit të përdorimit të saj. Kjo do të thotë se qytetarët që e paguajnë atë duhet të shohin dhe prekin efektin e tarifës së paguar prej tyre, pra të kenë përfitime të drejtpërdrejta nga shërbimet për të cilat ata paguajnë.
- ✚ Qytetarët duan që ajo që ofrohet nga njesitë e qeverisë vendore të jetë e mjaftueshme dhe të justifikojë atë që do të paguajnë për të. Nga ky këndvështrim rregull i parë i financave fiskale lokale duhet të jetë **“kurdoherë që të jetë e mundur zbato tarifa”**. Tarifat mbi shërbimet nuk duhet të shihen vetëm si një burim potencial shtesë i të ardhurave por edhe si një informacion mbi kërkesën ndaj sektorit publik dhe mjet për ekuilibrin midis rritjes së vlerës së shërbimeve dhe kostos që duhet të paguajnë qytetarët. Kështu, qytetarët do të konsumojnë shërbime me pagesë për aq kohë sa përfitimi i tyre do të jetë më i madh ose i barabartë me koston shtesë të kryerjes së shërbimeve.

## Nisur nga niveli dhe mënyra e zbatimit, tarifat e shërbimeve mund të jenë:

- tarifa direkte - kur përfaqësojnë çmimin e këtij shërbimi.
- tarifa indirekte - kur përfaqësojnë një shumë të caktuar pavarësisht nga shërbimi që kryhet
- ✚ **Tarifa direkte;** qytetarët paguajnë në varësi të shërbimit të marrë, sikurse janë pagesat për ujin, pagesa për plehrat, ndriçimi, gjelbërimi, etj.
- ✚ **Tarifat indirekte;** nuk bazohen në përdorimin faktik të shërbimit. Të tilla janë tarifa mbi pastrimin e territorit dhe heqjen e mbeturinave të krijuara nga aktivite biznesi, institucione shtetërore, apo për një banor ose familje, pagesa e ujit në bazë të vlerës së pasurisë ose numrit të anëtarëve të familjes etj.

### 7.1 TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR KOMUNITETIN : (PASTRIM, GJELBËRIM, MBLEDHJEN DHE LARGIMIN E MBETJEVE URBANE DHE INERTEVE).

- Tarifat paguhen nga çdo familje e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile dhe të verifikuar nga inspektorët e terrenit në bashkëpunim me njësitë administrative përkatëse, për të gjitha familjet që kanë në përdorim ndërtesë me qira, nëse jetojnë gjatë gjithë vitit apo në periudha sezonale në pronat e tyre apo që i kanë në përdorim ato. Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik.
- Për çdo familje të re të regjistruar gjatë vitit detyrimi arkëtohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit dhe ai llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit.

#### Familjarët pajisen me librezë të arkëtimit të taksave e tarifave.

Nr.	Emërtimi	Njësi matëse	Tarifë për vitin 2020 (qyteti) Rrëshen – Rubik - Reps	Tarifë viti 2020 njësitë administrative (ku kryhet shërbimi)
1	Tarifë shërbimi (pastrim, mbledhje dhe grumbullim mbeturinash)	Lekë/familje/vit	1 000	400
2	Ndricim		200	0
3	Gjelbërim		200	0
	Gjithsej tarife për shërbimet publike(1+2+3)		1 400	400

- Tarifës së shërbimeve publike dhe ndotjes së ambientit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, kompani apo shoqëri vendase ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të bashkisë Mirditë.

## 7.1.2. TARIFA E PASTRIMIT, MBLEDHJES, LARGIMIT TË MBETJEVE, URBANE DHE INERTEVE ETJ. TË NGJASHME PËR BIZNESIN E VOGËL.

Biznes i vogël konsiderohen të gjithë personat fizikë apo juridikë që realizojnë një qarkullim vjetor deri në 8 milion lekë. Kategoritë e nënkategoritë e biznesit dhe niveli përkates i tarifës janë si më poshtë:

Kur aktiviteti kryhet ne me shumë se ne nje njesi administrative brenda territorit të bashkisë, zbatohen ½ e tarifës vendosur per biznesin e vogel

Kur veprimtaria është njësi e rretheve të tjerë do të zbatohen taksat dhe tarifatat e plota te vendosura me poshtë;

N r	Përshkrimi	Brenda qyteteve			Gjithësej shërbime publike	Jashtë qyteteve			Lekë/vit	
		pastrim	ndricim	gjelbërim		Pastrim	gjelbërim	ndricim		
1	Të gjitha subjektet e biznesit te vogël që ushtrojnë aktivitet te lejuar te cfarëdo lloj natyre	Deri në 50 m2 ndërtesë	7 000	1 000	1 000	9 000	7 000	0	0	7 000
	Mbi 50 m2 ndërtesë	10 000	1 000	1 000	12 000	10 000	0	0	10 000	
2	Tarifë për institucionet shteterore	Q. shende dhe zyra	10 000	3 000	4 000	17 000	7 000	0	0	7 000
	Ndermarrjet shteterore , ndermarrjet sha. etj te ngjashme	30 000	3 000	4 000	37 000	30 000	0	0	30 000	

**7.1.3. TARIFA E PASTRIMIT, MBLEDHJES, LARGIMIT TË MBETJEVE, URBANE DHE INERTEVE ETJ. TË NGJASHME PËR BIZNESIN E MADH.**

Nr	Përshkrimi	Brenda qyteteve			Lekë/vit	Jashtë qyteteve			Lekë/vit
		Lekë/vit				Lekë/vit			
		Pastrim	Ndriçim	Gjelbëri m	<b>Gjithësej shërbime publike</b>	Pastrim	Gjelbër im	Ndriçim	<b>Gjithësej shërbime publike</b>
1									
2	Aktivite te BM shitje(supermarkete, dyqane etj te ngjashme...)	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
3	Akt. BM bar-restorante, disko, pube, diskoteka etj te ngjashme	20 000	3 000	4 000	27 000	20 000	0	0	20 000
4	Tregtim lëndë djegëse, karburant, gaz, etj.të ngjashme	100 000	3 000	4 000	107 000	100 000	0	0	100 000
6	Sallone ekspozimi shitje	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
7	Aktiviteti biznes i madh prodhues (furra buke,embeltore etj te ngjashme)	30 000	3 000	4 000	37 000	30 000	0	0	30 000
8	Prodhim materiale ndërtimi, tulla , tjegulla, çimento,etj. të ngjashme	100 000	3000	4000	107 000	100 000	0	0	100 000
9	Biznes me aktivitet prodhimi, përpunim, kerkim-zbulim hidrokarbure, hidroenergjitike, metalesh të ndryshme, krom, bakër, kërkime gjeologjike minerare e nënprodukte të tyre	200 000	3 000	4 000	207 000	200 000	0	0	200 000



	etj. të ngjashme me to sipas volumit, vendit dhe kapaciteteve								
10	Kërkime dhe shpime pusi uji nga subjekte te licensuara	100 000	3 000	4 000	107 000	100 000	0	0	100 000
11	Thertore bagëtish	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
12	Komplekse të rritjes e therjes për shpendë, derra, gjedhë, etj	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
13	Aktivite shërbimi BM (filjaje bankash etj te ngjashme )	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
14	Klinika mjekesore, stomatologjike, farmaceutike etj. të ngjashme, qendra shëndet e tjera të ngjashme private, institucione arsimore private etj të ngjashme.	30 000	3 000	4 000	37 000	30 000	0	0	30 000
15	Agjenci sigurimesh, transporti, exchange autoshkolla, kurse kualifikimi etj. te ngjashme, profesione te lira	20 000	3 000	4 000	27 000	20 000	0	0	20 000
16	BM me aktivitet prodhim energjie elektrike								
	- deri ne 2 mega	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000
	-mbi 2 mega	250 000	3 000	4 000	257 000	250 000	0	0	250 000

17	BM me aktivitet ndertim, prodhim , perpunim,nxjerrje asfalt, betoni, guri,inerte, argjile, zhavorri, lavatriqe, zalle brigje etj te ngjashme	150 000	3 000	4 000	157 000	150 000	0	0	150 000
18	BM me aktivitet rikonstuksione te ndryshme e tj te ngjashme	50 000	3 000	4 000	57 000	50000	0	0	50 000
19	Për cdo mjet ne inventra te shoqërive te transportit	7 000	3 000	4 000	7 700	7000	0	0	7 000
20	Agjensi dasmash, funeralesh etj te ngjashme	50 000	3 000	4 000	57 000	50000	0	0	50 000
21	Biznes me aktivitet turizmi, hotel, stabiliment turistik etj. të ngjashme	50 000	3 000	4 000	57 000	50 000	0	0	50 000

- Tarifa e shërbimeve pastrimit dhe largim të mbetjeve paguhet për çdo mjet në inventar të subjektit **fizik apo juridik** të regjistruar në QKB vetëm për transport dhe nuk arkëtojnë këtë tarifë si subjekt shpk.
- Në rastet kur periudha respektive është më pak se një vit (rastet kur certifikata e mjetit duhet të tejkalojë afatin e licencës), tarifa llogaritet proporcionalisht me periudhen disa mujore.
- Arkëtohen për cdo mjet transporti në inventar të subjektit fizik apo juridik, për aktivitetin e tyre biznes i madh apo i vogël që pajiset me leje transporti nga sektori i transportit.
- Shoqëritë e Transportit të udhëtarëve (SHPK), me aktivitet të regjistruar në QKB vetëm Transport udhëtarësh, arkëtojnë tarifën për cdo mjet në inventar dhe nuk arkëtojnë tarifën si subjekt shpk..
- Kur në dokumentet e regjistrimit kanë dhe aktivitet tjetër paguajnë edhe tarifën si subjekt i biznesit.
- Sektori i Transportit nuk jep leje transporti pa arkëtuar tarifën për cdo mjet.

Subjektet e BM,SHPK,shoqërite e ndryshme private që ushtrojnë dhe aktivitete të tjera sipas QKB do të tarifohen si subjekte me vete në nivelin e tarifimit të BV dhe aktiviteti kryesor si BM.

#### 7.1.4. TARIFA PËR MJETET E TRANSPORTIT

Tarifa e pastrimit për çdo mjet transporti të liçensuar për persona fizik ose juridik.

Nr.	Kategoritë e mjeteve sipas Kodit Rrugor	Treguesit e mjeteve		Tarifa pastrimit dhe largimit të mbetjeve
		Nr.i vendeve	Ngarkesa në ton	Lekë / vit
2	Taksi	4 + 1		5 000
3	Taksi	8 + 1		8 000
4	Autobuza	9 - 30		10 000
5	Autobuza	30 - 52		15 000
6	Kamion		1.5 - 3.5	5 000
7	Kamion		3.6 - 8	10 000
8	Kamion		8.1 - 14	20 000
9	Kamion		14.1 +	30 000
10	Autovinça		1-14	10 000
11	Autovinça		1.1 e lart	20 000
12	Makineri ngarkimi			10 000
13	Të tjerat mjete që nuk përmenden më lart			15 000

#### 7.1.5. TARIFA PËR DHËNIE LEJE, LIÇENCA DHE AUTORIZIME PËR USHTRIM AKTIVITETI

- Objekt i kësaj tarife janë ato aktivitete për të cilat detyrimisht duhet të plotësohen disa kushte përpara se ato të ushtrohen aktivitetin.
- Lejet jepen nga bashkia, (drejtoritë të cilat mbulojnë aktivitetin respektiv), pasi të jetë kontrolluar zbatimi i kushteve të përcaktuara.

*Tarifa llogaritet nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore me paraqitjen e akstratit të QKB ose kërkesën e subjektit për kategoritë dhe n/kategoritë nga subjekti për çdo personin fizik/juridik, sipas tabelës më poshtë:*

Nr.	Kategoritë / nënkategoritë	Niveli i tarifës në lekë
1	Për servis automjetesh, lavazh, parking privat	10 000
2	Për tregje privatë	10 000
3	Për aktivitet shërbimi funeral	10 000

4	Për disko, pub-e, etj. të kësaj natyre që krijojnë zhurma	10 000
5	Ushtrim aktiviteti në orar të zgjatur por të kufizuar.	5 000
6	Organizim spektakle, panaire, etj. të kësaj natyre në hapësira publike	3 000
7	Ushtrim aktiviteti non - stop 24 orë, etj. të ngjashme sipas tarifave të përcaktuara më lart,ktivite te ndryshme te pa permendura me lart	10 000

#### 7.1.6. TARIFA PËR SHËRBIMET VETERINARE

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Tarifa në lekë
<b>1</b>	<b>Për kontrollin dhe pajisjen me certifikatë të mishit, në thertoret emiratuara</b>		
	a) për bagëti të trasha	lekë/krerë	200
	b) Për bagëti të imta	lekë/krerë	50
	c) Për derra	lekë/krerë	100
	d) Për shpendë	lekë/krerë	5
<b>2</b>	<b>Për kontrollin e pajisjen me certifikatë të mishit në komplekset e rritjes dhe therjes se kafshëve.</b>		
	a) Për pula dhe zogj	lekë/krerë	2
	b) Për pula dhe gjela deti	lekë/krerë	3
	c) Për derra	lekë/krerë	50

*Tarifa për shërbimet veterinarë arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sipas nje kuponit të lëshuar nga inspektorati veterinar i bashkisë Mirditë.*

#### 7.1.7 TARIFAT E LICENCIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Nr.	Tarifa e licencimit të Transportit të Udhëtarëve	Njësia	Tarifa
1	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetase	lekë/5 vjet	75 000
2	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetase	lekë/mjet/vit	1 500
3	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetase	lekë/5 vjet	75 000
4	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetase	lekë/mjet/vit	1 500
5	Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	lekë/5 vjet	15 000
6	Licencë për agjenci ndërkombëtare	lekë/5 vjet	40 000
7	Licencë për transport udhëtarësh me taksi	lekë/mjet/5	20 000

		vjet	
	<b>Tarifa e Licencimit të Transportit të Mallrave</b>		
1	Licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/vit	8 000
2	Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/kapacitet	2 000
3	Certifikatë për transport mallrash për vete brenda vendit	lekë/kapacitet	2 000

- Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie, paguhet **30% (tridhjetë) përqind** e vlerës së plotë të tarifës.
- Për rastet e ndryshimeve në licencë/certifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit, etj. paguhet **30% (tridhjetë) përqind** e vlerës së plotë.
- Licencat model : **109** për transport malli, për të tretë me qira, do të jepen për një afat **1(një) vjeçar**.
- Tarifa e shërbimit për licencë, certifikatë ose autorizim në fushën e transportit **500** lekë.

#### 7.1.8. TARIFA E PARKIMIT

- Parkimi i jepet subjektit fizik apo juridik vetëm me Leje për Parkim të lëshuar nga Sektori i Transportit. Në lejen e lëshuar përcaktohet nr i vendparkimeve dhe vendndodhja e tyre.
- Leja për parkim jepet në përputhje me dispozitat e qarkullimit rrugor.
- Parkimi i automjeteve në parkingje të vijëzuara nga bashkia sipas biletave të tregut deri në **1 (një) orë falas. Mbi 1 orë 100 (njëqind) lekë/orë.**

Nr.	Kategoritë / nënkategoritë	Për vitin 2020	
		Bashki	Nj.administrative
1	Për çdo vend parkimi autoveture 4+1 dhe 8+1	20 000	5 000
2	Për çdo vendparkimi autobus apo kamion	30 000	10 000

#### 7.1.9 TARIFA PËR DHËNIE LICENCE PËR TREGËTIM KARBURANTI E LËNDE DJEGËSE.

Niveli i tarifës dhe kushtet për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj përcaktohen me VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Nr	Tarifa për autorizim shitje karburanti	Njësia e matjes	Tarifa
1	Autorizim shitje karburanti me pakicë	Lekë/autorizim	200 000

Të ardhurat që realizohen nga pagesat e tarifave përdoren në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas përcaktimeve përkatëse.

#### 7.1.10. TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup> e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive është si vijon:

NR	KETEGORIA DHE NËNKATEGORIA	RRËSHEN, RUBIK DHE AKSI I AUTOSTRADËS	NJËSITË E TJERA ADMINISTRATIVE
<b>I</b>	Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)		
	<b>NËNKATEGORITË</b>		
<b>1</b>	Organizimi i spektakleve ose panairove të ndryshme	100 lekë/m <sup>2</sup> /muaj	50 lekë/m <sup>2</sup> /muaj
<b>2</b>	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në tregjet publike të administruara nga nj/administrative	100 lekë/m <sup>2</sup> /muaj	50 lekë/m <sup>2</sup> /muaj

#### ❖ . TARIFAT PËR ZËNIE TË HAPËSIRËS PUBLIKE:

- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme, struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Drejtoria e Taksave Vendore, pas marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit, nga struktura përkatëse që jep edhe lejet për ushtrim aktiviteti në bashkinë Mirditë. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar në tregjet publike të bashkisë Mirditë, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë Së Të Taksave Dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me njësitë administrative. Të ardhurat kalojnë **100 %** për Bashkinë Mirditë dhe bashkëpunimi me njësitë administrative rregullohet me rregullore të vecantë.
- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqet e rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drure dekorativë, kufizime me plastmasë dhe sende të tjera të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet (nqs. do lidhet kontrate me subjektin lidh tarifat do jene vjetore)

- Tarifë për zënien e hapësirës në zonat publike ose para mjediseve të biznesit, për qëllime biznesi, përfshirë këtu tavolinat jashtë për baret dhe restorantet...200 lekë/tavolinë në muaj.
- Tarifë për përdorimin e tabelave të reklamave ..... 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarifë për zënien e hapësirave të parkimit për mjetet motorike ..... 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarifë për zënien e sipërfaqeve për kamping, ngritje tendash dhe mjedesh të tjera për përdorim të përkohshëm. .... 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarifë për zënien e brigjeve ujore për biznes dhe qëllime të tjera..... 100 lekë/m<sup>2</sup>muaj.
- Tarifë për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të lundrimit dhe objekteve të tjera në det, lumenj ose liqene ..... 1 000 lekë/muaj.
- Tarifë për mbajtjen dhe përdorimin e barakave dhe platformave pluskuese, përjashtuar këtu barakat që përdoren nga organizatat e angazhuara në mirëmbajtjen dhe shënimin e rrugëve ujore ..... 5 000 lekë/muaj.
- Tarifë për restorante dhe mjedise të tjera ushqimi dhe argëtimi pranë detit, lumenjve dhe liqeneve..... 200 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarifë për zënien e hapësirës publike për rulota dhe trajler, përveç automjeteve bujqësore dhe makinerive bujqësore ..... 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarifë për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit dhe të tjerave në dispozicion të bizneseve apo për tregtimin e tyre..... 30 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Tarife për përdorimin sipërfaqeve jo hapësirë publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit dhe të tjerave në dispozicion të bizneseve apo për tregtimin e tyre 20 lekë/m<sup>2</sup>/muaj.
- Për linjat kablllore dhe tunelet e natyrave të ndryshme nëntokësore dhe në hapësira në pronësi të bashkisë..... 20 lekë/km/vit.
- Për linjat ajrore ..... 20 lekë/ml/vit.
- Për linja e fibrave optike..... 20 lekë/km/vit.
- Tarifë për shfrytëzimin e pasurive si nxjerrje dhe përpunim bakri, argjile, inerte, bazalte të ndryshme, krom, ujë për hecet etj të ngjashme me to në territorin e bashkisë .....200 000 lek/vit.

### **7.1.11. TARIFA TË PËRKOHSHME**

1. Tarifa e kalimit mbi aks për mjetet e tonazhit të lartë:
  - Kamiona nga 2-10 ton                      10 000 lekë/vit
  - Kamiona mbi 10 ton                      30 000 lekë/vit

### **7.1.12. TARIFË PËR PRIVATIZIMIN NGA BASHKIA E NDËRTESAVA TË NDËRTUARA PARA DATËS 10.08.1991**

Bazuar ne VKM nr 608 date 05.09.2012 “Per percaktimin e procedures te kalimit te pronesisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri me 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi, si dhe regjistrimin e tyre” si dhe ne VKM nr 614 date 7.7.2015 “Per percaktimin e procedurave te privatizimit te banesave dhe objekteve te kthyer ne banesa me vendime te organeve e qeverisjes vendore, ne pronesi te organeve te qeverisjes vendore dhe te shtetit, ku jane sistemuar me strehim banore te pajisur me autorizim nga organet e kompetente / bashkia ka përcaktuar keto tarifa:

- Per kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri me 10.08.1991 ..... 15 000 lekë për cdo regjistrim.
- Per percaktimin procedurave të privatizimit të ndërtesave të kthyer në banesa .....5 000 lekë për çdo banesë.

### **7.1.13. TARIFA E LËNDËS DRUSORE PËR NGROHJE ME ZJARR PËR FAMILJARËT.**

- Tarifa është 500 lekë për mst. (metër sterë).

### **7.1.14. TARIFA TË TJERA**

- Tarifë për përdorimin e pyjeve dhe kullotave (projekt i paraqitur nga sektori i pyjeve) *Baza ligjore:* Ligji 9385 date 4.5.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor “të ndryshuar, neni nr 34, ligji 9693 datë 19.3.2007”per fondin kullosor” (i ndryshuar), VKM nr 391 date 21.6.2006”Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave “ (i ndryshuar) me VKM 1064 datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime në vendimin nr 391 date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave” për përcatimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave dhe aktet nënligjor me ndryshimet perkatese.
- Tarifë për përdorimin e zjarrfikëses (projekt i paraqitur nga pmmzsh)
- Tarifë për depozitim mbetjesh në landfill (projekte të paraqitura nga sektori i mbrojtjes së mjedisit)



## 7.1.15. TË ARDHURA NGA QIRATË E OBJEKTEVE

*Baza ligjore:* VKM nr 54 date 5.2.2014 “Per percaktimin e kritereve, procedurave e menyres se dhenies me qira, enfiteoze, apo kontrata te tjera te pasurise shtetore (i ndryshuar), udhezimit nr 6756 date 3.9.2015 “per zbatimin e VKM nr 54 date 5.2.2014”Per percaktimin e kritereve te procedurave dhe menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetore“ ( i ndryshuar).

Te ardhurat nga qirat paguhen nga perfituesi apo shfrytezuesi i prones së bashkisë.

- Për dhënien me qera të objekteve pronë e bashkisë në zbatim të VKM nr.1712, datë 24.12.2008, çmimi të jetë..... 150/lekë/m<sup>2</sup>.
- Qiraja e tregut. .... 150/lekë/m<sup>2</sup>
- Qira objekte te rikonstruktuar..... 300/lekë/m<sup>2</sup>
- Qira objektet e parikonstrukturuara ..... 200/lekë/m<sup>2</sup>

## II. Mënyra e pagesës:

- Shuma e detyrimit është vjetore detyrimi fillon me 1 Janar- 31 dhjetor te vitit kalendarik.
- Detyrimi për taksat vendore do të paguhet në dy këste;
  - kësti I deri me datë **20 Prill 2020**.
  - kësti i II deri me datë **30 Qershor 2020**.
- Mos arkëtimi në afat sistemi përlllogarit kamavonesë në **0.06 % (zero pikë zero gjashtë) përqind** në ditë e shumës detyrimit të paarkëtuar për 365 ditë.
- Për arkëtimin brenda vitit kalendarik aplikohet gjobë **5,000** (pesë mijë) për biznesin e vogel dhe **10,000** (dhjetemijë)
- 
- leke për biznesin e madh.
- Kur pagesa kryhet totale vjetore brenda datës **20 Prill**, taksapaguesi përfiton zbritje në masën **5% (pesë) përqind** e shumës detyrimit.

## III. Pagesa do të kryhet në:

- Pranë filialeve te bankave të nivelit II, Postën Shqiptare, arkën e njësive administrative ku është rezident ose në arkën e bashkisë qendër apo në cdo institucion tjetër ku mund të kryhen pagesa e tjera.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i bashkisë (drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, drejtoria e menaxhimit financiar

dhe buxhetit, agjencitë, njësitë administrative, institucionet dhe ndërmarrjet e varësi të Bashkisë Mirditë).